

PLANI STRATEGJIK I SISTEMIT PROKURORIAL 2025-2027

Prishtinë
10 Dhjetor 2024



Përmbajtja	
Shkurtesat.....	3
Metodologjia e hartimit të Planit strategjik	4
Përmbledhje e përgjithshme.....	4
Misioni	6
Vizioni.....	6
Vlerat.....	6
Struktura e sistemit prokurorial	6
Këshilli Prokurorial i Kosovës.....	6
Shtylla I: Forcimi i sundimit të ligjit.....	8
Objektivi 1. Pavarësia e sistemit prokurorial.....	8
Objektivi 2. Forcimi i llogaridhënies, etikës dhe mbikëqyrjes brenda sistemit prokurorial.....	8
Objektivi 3. Sigurimi i menaxhimit dhe administrimit adekuat të sistemit prokurorial	9
Shtylla II: Luftimi i krimit	12
Objektivi 1. Lufta kundër veprave komplekse me fokus të veçantë korrupsionin dhe krimet ekonomike.....	12
Objektivi 2. Lufta kundër dhunës me baza gjinore, dhunës në familje dhe abuzimit të fëmijëve.....	13
Objektivi 3. Shtimi i angazhimit për trajtimin e krimeve të luftës	14
Objektivi 4. Luftimi i terrorizmit, ekstremizmit dhe veprave kundër rendit kushtetues	15
Objektivi 5. Sigurimi i një sistemi efikas të ndjekjes penale.....	15
Shtylla III: Transparenca dhe qasja në drejtësi	17
Objektivi 1. Transparenca përmes publikimit proaktiv dhe qasjes në dokumente	17
Objektivi 2. Avancimi i bashkëpunimit me shoqërinë civile, mediat dhe partnerët ndërkombëtarë.....	17
Buxheti.....	18
Monitorimi i zbatimit të Planit strategjik.....	19
Plani i veprimit.....	20

Shkurtesat

KPK	Këshilli Prokurorial i Kosovës
ZKPSH	Zyra e Kryeprokurorit të Shtetit
PSH	Prokurori i Shtetit
PSRK	Prokuroria Speciale e Republikës së Kosovës
PA	Prokuroria e Apelit
PTH	Prokuroria Themelore
SKPK	Sekretariati i Këshillit Prokurorial të Kosovës
SMIL	Sistemi për Menaxhimin Elektronik të Lëndëve
NJSHPP	Njësi për Shqyrtimin e Performancës së Prokurorëve

Metodologjia e hartimit të Planit strategjik

Plani strategjik i sistemit prokurorial 2025-2027 është hartuar mbi bazën e një analize të detajuar të vlerësimit të zbatimit të Planit strategjik të sistemit prokurorial për periudhën 2022-2024. Për hartimin e këtij raporti janë përdorur raportet e brendshme të Këshillit dhe Prokurorit të Shtetit si dhe të dhënat që janë ofruar nga njësitë përgjegjëse për zbatimin e objektivave dhe aktiviteteve konkrete. Ky vlerësim ka paraqitur për secilin aktivitet të arriturat, zbatueshmerinë, sfidat dhe rekomandimet për zhvillimin e mëtutjeshëm të objektivave dhe aktiviteteve në periudhën e ardhshme.

Ky proces për hartimin e Strategjisë është udhëhequr nga Këshilli Prokurorial i Kosovës në konsultim me kryeprokurorët e prokurorive, prokurorët dhe njësitë përgjegjëse të administratës së sistemit prokurorial.

Një përkrahje shumë domethënëse kanë ofruar edhe partnerët tanë ndërkombëtarë.

Përmbledhje e përgjithshme

Plani strategjik i sistemit prokurorial 2025-2027 paraqet kornizën kryesore të planifikimit të politikave për menaxhimin e sistemit prokurorial të Republikës së Kosovës për periudhën e sipërpërmendur.

Plani ka për qëllim zhvillimin dhe përmirësimin e funksionimit të sistemit prokurorial, duke garantuar ndjekjen e procedurave të drejta dhe efektive në trajtimin e çështjeve ligjore. Ky plan është një përpjekje e rëndësishme për të siguruar që sistemi prokurorial të funksionojë në përputhje me standardet ndërkombëtare të drejtësisë dhe për të mbrojtur të drejtat e qytetarëve të Kosovës. Mandati kushtetues dhe ligjor i Këshillit dhe Prokurorit të Shtetit synohet të arrihet përmes tre shtyllave strategjike, si vijojnë më poshtë:

Shtylla 1: Forcimi i sundimit të ligjit;

Shtylla 2: Efikasiteti në luftimin e krimit, dhe

Shtylla 3: Transparenca dhe qasja në drejtësi.

Sistemi prokurorial synon t'i ofrojë publikut dhe akterëve të tjerë njohuri mbi qëllimet strategjike që sistemi kërkon të arrijë gjatë tre vjetëve të ardhshëm, me synimin për të arritur

vizionin për një sistem profesional, llogaridhënës, të qëndrueshëm, të paanshëm, efektiv, efikas dhe me etikë të lartë të punës.

Avancimi i qëllimeve strategjike, të përshkruara si më sipër, do të arrihet përmes objektivave dhe strategjive sipas këtij plani dhe aktiviteteve të pasqyruara në Planin e veprimit.

Misioni, vizioni dhe vlerat e sistemit prokurorial

Misioni

Forcimi i sundimit të ligjit, rritja e efikasitetit në luftimin e krimit dhe ngritja e transparencës së sistemit prokurorial dhe qasjes së barabartë në drejtësi për të gjithë qytetarët.

Vizioni


Një sistem prokurorial i pavarur, efikas dhe etik, që vepron në mënyrë profesionale, llogaridhënëse dhe të paanshme, duke siguruar drejtësi të besueshme për qytetarët e Kosovës.

Vlerat


Sistemi prokurorial do të udhëhiqet nga standarde dhe vlera të larta siç janë:

- Profesionalizmi, integriteti, dinjiteti, etika dhe pavarësia në punë;
- Llogaridhënia dhe transparenca;
- Përmirësimi i vazhdueshëm i cilësisë së punës dhe përdorimi racional i resurseve dhe
- Efikasiteti dhe efektiviteti në punë.

Struktura e sistemit prokurorial Këshilli Prokurorial i Kosovës



Prokurori i Shtetit



Shtylla I: Forcimi i sundimit të ligjit

Një sistem profesional, i pavarur, transparent dhe llogaridhënës është gurthemel për sundim të mirëfilltë të ligjit. Mbikëqyrja efektive dhe përgjegjshmëria në ushtrimin e detyrave dhe funksioneve publike të të gjithë punonjësve të sistemit prokurorial, pa dallim, ndihmojnë për të siguruar që ky sistem t'u qëndrojë besnik qëllimeve dhe vlerave të tij. Sistemi prokurorial do të vazhdojë angazhimin, që publiku të shohë sistemin si objektiv, të paanshëm dhe të mbrojtur nga ndikimet e padrejta.

Objektivi 1. Pavarësia e sistemit prokurorial

Sistemi prokurorial do të jetë i përkushtuar ndaj rolit të tij si pjesë përbërëse e rendit kushtetues të kontrollit dhe balancimit, duke ruajtur pavarësinë nga shtyllat e tjera dhe llogaridhënien e tij ndaj qytetarëve. Sistemi prokurorial do të trajtojë mangësitë e sistemit, duke e mbrojtur vendimmarrjen nga presioni apo ndërhyrjet e panevojshme, si nga ato të brendshmet, po ashtu, edhe nga ato të jashtmet, si dhe duke demonstruar paanshmëri dhe integritet në angazhimet e përditshme.

Strategjia 1. Angazhimi për shmangien e ndikimeve të padrejta në punën e sistemit prokurorial

Prokurorët duhet të jenë të mbrojtur nga të gjitha format e ndikimit të padrejtë në hetimet dhe ndjekjet penale të tyre.

Sigurimi i pavarësisë së sistemit prokurorial, duke përfshirë pavarësinë e prokurorëve, duke krijuar mekanizma të fuqishëm për të identifikuar, trajtuar dhe parandaluar ndikimin e panevojshëm të brendshëm dhe të jashtëm, duke përfshirë trajnimin, mekanizmin e përmirësuar të sinjalizimit, monitorimin dhe mbrojtjen e shtuar për prokurorët.

Objektivi 2. Forcimi i llogaridhënies, etikës dhe mbikëqyrjes brenda sistemit prokurorial

Llogaridhënia është parakusht kryesor për besimin e publikut në sistemin prokurorial. Për të rritur këtë besim, sistemi prokurorial është i përkushtuar për të forcuar mbikëqyrjen, disiplinën dhe vlerësimet e drejta të performancës. Synimi ynë është të ndërtojmë një sistem prokurorial që respekton standardet e larta etike dhe funksionon me profesionalizëm dhe integritet. Përgjegjësia e kryeprokurorëve dhe udhëheqësve të tjerë brenda sistemit prokurorial është një komponent shumë e rëndësishme për ngritjen e kësaj llogaridhënieje. Udhëheqja transparente dhe e përgjegjshme ndikon drejtëpërdrejt në efikasitetin e hetimeve penale, qasjen në drejtësi dhe përdorimin e duhur të burimeve publike.

Strategjia 1. Fuqizimi dhe reformimi i sistemeve për vlerësimin e performancës, disiplinimin dhe kontrollin e integritetit

Sistemi prokurorial do të angazhohet aktivisht në forcimin e kuadrit ligjor, duke synuar që të nxisim një kulturë përgjegjësie dhe sjelljeje etike në tërë sistemin. Një gjë e tillë do të arrihet

përmes ose pjesëmarrjes dhe kontributit aktiv në hartimin e ligjeve përkatëse që adresojnë këto fusha, apo edhe përmes rishikimit të akteve nënligjore të sistemit. Një theks i veçantë do të vihet në garantimin e transparencës dhe përmirësimin e llogaridhënies dhe etikës, duke forcuar procedurat disiplinore përmes marrjes së veprimit të duhur për shkeljet e pretenduara, shqiptimit të sanksioneve proporcionale me shkeljet e vërtetuara, por edhe në rritjen e transparencës lidhur me vendimmarrjen e autoriteteve kompetente dhe të Këshillit. Metodot për masën e përshtatshme dhe cilësinë e punës së prokurorëve do të forcohen dhe shërbejnë si bazë për avancimin e mëtejshëm, duke motivuar një angazhim më të madh nga të gjithë prokurorët.

Strategjia 2. Përmirësimi i llogaridhënies dhe efikasitetit të mbikëqyrjes

Sistemi prokurorial do të krijojë përmes kësaj strategjie një kornizë rregullatore gjithëpërfshirëse, duke përcaktuar qartë pritshmëritë e performances për kryeprokurorët që lidhen me performancën e prokurorisë, duke krijuar indikatorë të matshëm të performancës për të promovuar udhëheqje efikase, transparente dhe llogaridhënëse. KPK-ja do të krijojë një metodologji për monitorimin e performances së kryeprokurorëve, duke u bazuar në të dhënat e krijuara nga SMIL-i dhe do të përcaktojë përgjegjësinë e KPK-së për të mbështetur ose marrë veprime korigjuese në rastet e performancës së dobët. Sistemi prokurorial do të sigurojë transparencë dhe qasje të publikut në të dhënat për performancën e prokurorëve, duke përfshirë publikimin e vazhdueshëm të të dhënave në portalin e sistemit prokurorial.

Strategjia 3. Forcimi i llogaridhënies dhe performancës së zyrtarëve të sistemit prokurorial

Zhvillimi i kapaciteteve të zyrtarëve mbështetës brenda sistemit prokurorial është po aq i rëndësishëm sa edhe zhvillimi i prokurorëve, ngaqë ekspertiza dhe efikasiteti i tyre ndikojnë drejtpërdrejt në aftësinë e prokurorëve për të kryer detyrat e tyre me efektivitet. Një sistem i strukturuar për zhvillimin e karrierës do të dizajnohet për të rritur zhvillimin profesional dhe për të mundësuar shpërndarjen dinamike të burimeve. Do të krijohen mekanizma për të promovuar një kulturë ku inkurajohen dhe vlerësohen informatat kthyesë, duke përfshirë një sistem të strukturuar për trajnime të synuara dhe të vazhdueshme.

Sistemi prokurorial do të angazhohet në hartimin e akteve të mbetura që trajtojnë çështjen e etikës dhe llogaridhënies brenda sistemit dhe në implementimin e rregullativës ekzistuese.

Objektivi 3. Sigurimi i menaxhimit dhe administrimit adekuat të sistemit prokurorial

Ky objektivi përqendrohet në angazhimin tonë për të investuar në zhvillimin e kapaciteteve dhe profesionalizmin e prokurorëve dhe personelit që shërben në sistemin prokurorial. Profesionalizmi është thelbësor për trajtimin adekuat të çështjeve, efikasitetin dhe besueshmërinë e tërë sistemit. Sistemi prokurorial do të angazhohet për promovimin e diversitetit gjinor dhe etnik, i cili reflekton pluralizmin dhe diversitetin e shoqërisë. Sistemi prokurorial do të angazhohet edhe në avancimin e infrastrukturës së sistemit, me qëllim të përmirësimit të efikasitetit në përgjithësi.

Strategjia 1: Ndarja dhe strukturimi adekuat i resurseve për ushtrimin e funksioneve

prokuroriale

Sistemi prokurorial do të angazhohet në ndarjen dhe përdorimin e resurseve në përputhje me prioritetet dhe kërkesat operative të sistemit për mbulimin e të gjitha funksioneve, duke përfshirë hetimet, ndjekjen penale dhe mbështetjen administrative dhe logjistike të institucionit të Prokurorit të Shtetit dhe KPK-së. Proceset financiare do të përmirësohen me anë të krijimit të një procesi që do të përqendrohet në vlerësimin e nevojave aktuale dhe në performancë, duke siguruar shfrytëzimin efektiv të burimeve dhe identifikimin e mundësive për përmirësim të efikasitetit. Prosesi do të përfshijë shfrytëzimin efektiv dhe dinamik të burimeve njerëzore. Ky proces do të përfshijë edhe hartimin e raporteve periodike dhe analizave të performancës së këtyre resurseve për t'u siguruar që të njëjtat janë përdorur në mënyrë efektive dhe për të identifikuar mundësitë për përmirësim.

Strategjia 2: Prioritizimi i diversitetit gjinor dhe etnik në sistemin prokurorial

Sistemi prokurorial do të angazhohet për të pasur një mjedis pune të barabartë dhe të respektueshëm. Sistemi do të sigurohet që në aktet nënligjore dhe vendimet e marra të ketë gjithnjë në fokus përfaqësimin gjinor, duke përfshirë ndërmarrjen e masave specifike për të parandaluar çdo formë të diskriminimit, përcaktimin e mekanizmave të qartë për ankesat e diskriminimit dhe për t'u siguruar që çdo ankesë trajtohet në mënyrë të drejtë dhe të barabartë. Sistemi do të angazhohet për të tërhequr dhe inkurajuar pjesëmarrjen e kandidatëve nga komunitetet joshumicë për t'u bërë pjesë e sistemit prokurorial, duke kontribuar në pasurimin dhe diversifikimin e tij.

Strategjia 3: Ndërtimi i kapaciteteve të prokurorëve dhe zyrtarëve në fushat e specializuara

Në kuadër të sistemit prokurorial tashmë janë caktuar një numër i prokurorëve të specializuar për trajtimin e lëndëve specifike. Gjatë periudhës trevjeçare do të angazhohemi që të forcojmë edhe më tutje kapacitetet e tyre, duke siguruar që ata të jenë të përgatitur për të trajtuar çështje komplekse dhe të ndryshme që kërkojnë njohuri dhe aftësi të veçanta. Sistemi do të fokusohet, sipas nevojës, edhe në specializimin e prokurorëve dhe bashkëpunëtorëve profesionalë në fusha të tjera, duke përfshirë edhe specializimin e prokurorëve në Prokurorinë e Apelit për trajtimin e rasteve që janë kompetencë e Prokurorisë Speciale. Po ashtu do të organizohen trajnime të avancuara dhe mundësi për specializime ndërkombëtare. Shkëmbimi i përvojave në mes të prokurorëve do të mundësojë harmonizimin e praktikave.

Gjithashtu do të kryhet vlerësimi dhe monitorimi i vazhdueshëm i performancës për të siguruar përmbushjen e detyrave të besuara.

Strategjia 4: Trajnime të vazhdueshme profesionale për prokurorë dhe zyrtarë

Trajnimi i vazhdueshëm i prokurorëve dhe personelit mbështetës është vital, duke pasur parashysb ndryshimet e shpeshta në infrastrukturën ligjore, avancimin e teknologjisë informative dhe nevojës për inkorporimin e praktikave dhe standardeve ndërkombëtare. Për arritjen e këtij këte synimi është thelbësor bashkëpunimi i ngushtë me Akademinë e Drejtësisë. Trajnimet duhet të jenë të lidhura ngushtë me praktikën e përditshme të prokurorëve dhe personelit mbështetës dhe njëkohësisht duhet të mos paraqesin pengesë për realizimin e detyrave të përditshme. Për të siguruar që trajnimi të jetë efektiv dhe i vlefshëm, sistemi do të angazhohet për vlerësimin e vazhdueshëm të nevojave dhe të ndjekjes së trajnimeve në përmirësimin e praktikave. Sistemi prokurorial do të krijojë mekanizëm për vlerësim të trajnimeve të vazhdueshme për prokurorët dhe stafin, si dhe do të sigurojë që prokurorët dhe stafi të mos marrin pjesë në trajnime të përsërituara dhe joadekuate.

Strategjia 5: Avancimi i infrastrukturës së sistemit prokurorial

Kjo strategji bazohet në avancimin e infrastrukturës fizike për ambiente të punës adekuate dhe për avancimin e infrastrukturës së teknologjisë informative. Përdorimi i teknologjive moderne për menaxhimin e informacionit dhe optimizimin e proceseve prokuroriale është thelbësor për efikasitetin e punës. Kjo përfshin investimet në sistemin e menaxhimit të rasteve, qasjes së palëve në të dhëna, gjenerimin e raporteve statistikore dhe analitike, me qëllim të vlerësimit të prokurorëve individualisht, por edhe performancës së prokurorive përkatëse.

Strategjia 6: Monitorimi i efikasitetit të prokurorive me anë përdorimit të menaxhimit të bazuar në dëshmi

Krijimi i një metodologjie që vendos SMIL-in në qendër të vlerësimit dhe monitorimit të performancës së prokurorëve dhe prokurorive, duke përdorur raporte të standardizuara me tregues të matshëm të performancës. Këto raporte duhet të shërbejnë si bazë për vlerësimin e performancës dhe vendimet e menaxhimit të bazuara në prova, duke siguruar llogaridhënie dhe efikasitet të optimizuar të prokurorisë.

Shtylla II: Luftimi i krimit

Një gjyqësor dhe prokurori efikase përbëjnë një garanci thelbësore për ruajtjen e sundimit të ligjit dhe sigurimin e gjykimeve të drejta, sipas nenit 6 të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut. Sistemi do të punojë në bashkëpunim të ngushtë me institucionet e tjera ligjzbatuese vendore dhe ndërkombëtare, duke siguruar një qasje të koordinuar për të luftuar aktivitetet kriminale. Sistemi prokurorial po ashtu synon një mbështetje të qëndrueshme dhe qasje më të lehtë për viktimat. Republika e Kosovës si shtet i ri dhe me synimin drejt integriteteve evropiane vlerësohet në vazhdimësi në saje edhe të progresit në luftimin efikas sidomos të kategorive të veçanta të veprave penale. Si rezultat, sistemi prokurorial edhe përmes kësaj strategjie ka prioritetizuar luftimin e veprave të caktuara, pa përjashtuar ngritjen e efikasitetit të sistemit si tërësi.

Objektivi 1. Lufta kundër veprave komplekse me fokus të veçantë korrupsionin dhe krimet ekonomike

Avancimi i luftës kundër korrupsionit, shpërlarjes së parave, krimit të organizuar, krimit kibernetik, veprave me kontekst transnacional dhe veprave të tjera të kësaj natyre që kanë ndikim në stabilitetin dhe sigurinë e Republikës së Kosovës janë në qendër të vëmendjes së sistemit prokurorial. Rritja në masë e krimit kibernetik dhe përdorimit të kriptomonedhave iu ka dhënë mundësi të jashtëzakonshme keqbërësve të sigurojnë mjete, të bashkëpunojnë dhe të pastrojnë të ardhurat e tyre kriminale në mënyra të reja dhe sfiduese për sistemin prokurorial dhe për shtetin.

Ky objektivi do të realizohet përmes një morie strategjish në drejtim të përmirësimit jo vetëm të efikasitetit në numra, por edhe në cilësi të trajtimit të këtyre rasteve. Kjo përfshin hetimin dhe ndjekjen e plotë të rasteve, duke rezultuar në dënime të bazuara në prova, duke mbrojtur të drejtat e palëve të përfshira, koordinimin, luftimin efikas të rrjeteve kriminale dhe rikuperimin e përfitimeve të paligjshme.

Njësitë për Luftimin e Korrupsionit dhe Krimeve Ekonomike në Prokurorinë Themelore në Prishtinë do të vazhdojë funksionimin e tij për trajtimin me prioritet të rasteve të korrupsionit dhe avancimin e praktikave dhe standardeve më të larta në hetimin, ndjekjen dhe zbulimin e kryesve të këtyre veprave penale. Sistemi prokurorial do të angazhohet në fuqizimin e mekanizmit përkatës (Komisioni) për mbikqyrje të vazhdueshme të Njësitit dhe mbikqyrjen e të gjitha prokurorive në luftën kundër korrupsionit.

Strategjia 1. Përmirësimi i cilësisë të ndjekjes së veprave penale komplekse dhe trajtimi me efikasitet i rasteve të pazgjidhura

Sistemi prokurorial do ta forcojë cilësinë e ndjekjes penale, duke i përmirësuar proceset, përfshirë zbatimin e mjeteve dhe teknikave të avancuara për mbledhjen e provave, duke krijuar praktika standarde për hartimin e aktakuzave të qarta dhe të argumentuara mirë, duke e përmirësuar trajnimin për prokurorët dhe përmes vlerësimeve të rregullta të procesit për t'i vlerësuar përmirësimet në cilësi. Me ngritjen e cilësisë së hetimeve dhe akteve akuzuese, paralelisht do të punohet në një qasje më proaktive të prokurorëve gjatë përfaqësimit në gjykatë dhe parashtrimin të mjeteve juridike.

Sistemi prokurorial do të kujdeset në mënyrë të veçantë që rastet e grumbulluara dhe të

pazgjidhura, me theks të veçantë në Prokurorinë Themelore në Prishtinë dhe Prokurorinë Themelore në Mitrovicë.

Strategjia 2: Rritja e bashkëpunimit kolegjial, ndërinstytucional dhe ndërkombëtar

Rritja e bashkëpunimit kolegjial, ndërinstytucional dhe ndërkombëtar është thelbësore për luftimin e suksesshëm të krimit të organizuar dhe veprave të tjera komplekse. Bashkërendimi dhe koordinimi i aktiviteteve me Policinë e Kosovës dhe organizata e tjera si: Interpol, Europol dhe agjenci të tjera të rëndësishme për luftimin e veprave të natyrave komplekse, sigurojnë një qasje të koordinuar dhe të efektshme, duke mundësuar ndjekjen e veprave penale përtej kufijve dhe përballimin e kërcënimeve vendore dhe globale të sigurisë. Luftimi i krimeve elektorale paraqet një tjetër angazhim të jashtëzakonshëm të sistemit prokurorial me një bashkërendim të jashtëzakonshëm me institucioneve përgjegjëse, falë të cilit është shtuar edhe besimi i publikut në proceset demokratike. Andaj, i njëjti angazhim do të reflektohet edhe gjatë procesve elektorale që do zhvillohen gjatë kohëzgjatjes së kësaj strategjie.

Strategjia 3. Avancimi i përpjekjeve për sekuestrimin dhe konfiskimin e aseteve

Sistemi prokurorial do të rrisë angazhimin në identifikimin dhe konfiskimin e pasurive të paligjshme. Në këtë aspekt, sistemi prokurorial do të punojë në drejtim të unifikimit të praktikave, shtimit të përpjekjeve për rikuperimin e aseteve, vlerësimit dhe monitorimit të vazhdueshëm të performancës së prokurorëve në drejtim të konfiskimit të pasurisë, duke realizuar gjithçka që është në kompetencën e prokurorit të shtetit për të goditur asetet që lidhen me veprat fitimprurëse.

Strategjia 4: Mbrojtja e dëshmitarëve dhe sinjalizuesve

Një tjetër angazhim i sistemit prokurorial do të jetë mbrojtja e dëshmitarëve duke siguruar mekanizma të sigurt dhe të besueshëm për mbrojtjen e tyre pa pasur frikë për pasojat. Mbrojtja e sinjalizuesve është po aq e rëndësishme për detektimin efektiv të korrupsionit, duke qenë se ata ofrojnë informacion të vlefshëm dhe shpesh të pakontestueshëm mbi abuzimet brenda institucioneve, andaj edhe mbrojtja e tyre jo rastësisht është në qendër të vëmendjes së standardeve ndërkombëtare. Është synimi ynë që mbrojtja e tyre të avancohet dhe promovohet edhe nga sistemi prokurorial si shtyllë kyçe në mbrojtjen e tyre.

Objektivi 2. Lufta kundër dhunës me baza gjinore, dhunës në familje dhe abuzimit të fëmijëve

Republika e Kosovës ka inkorporuar në kuadër të Kushtetutës edhe Konventën e Stambollit, e cila na obligon në trajtimin me prioritet dhe efikas të dhunës në familje, dhunës ndaj grave dhe dhunës në baza gjinore, përfshirë edhe të gjitha veprat kundër integritetit seksual. Për këtë qëllim, sistemi prokurorial ka caktuar edhe prokurorë të specializuar për trajtimin e këtyre veprave me synimin për trajtim adekuat të tyre duke u bazuar edhe në specifikat që ato bartin. Sistemi ka edhe një përparësi dhe ajo është përfshirja e Zyrës për Mbrojtje dhe Ndihmë Viktimave në kuadër të strukturës së Prokurorit të Shtetit. Mbrojtja e fëmijëve të ndikuar direkt apo indirekt nga këto vepra është po aq e rëndësishme. Si sistem do të angazhohemi në drejtim të avancimit të ndjekjes penale, bashkëpunimit ndërkolegjial për përfshirje të praktikave më të mira, bashkëpunimit më të ngushtë brenda dhe jashtë institucionit për mbajtjen përgjegjës të kryesve të veprave penale, rritjes së ndërgjegjësimit të publikut, në mënyrë që të ofrojmë mbështetje dhe mbrojtje për viktimat, duke adresuar ndjeshmëritë e viktimave dhe duke parandaluar dëme të mëtejshme.

Strategjia 1: Prioritizimi i trajtimit të veprave me rrezikshmëri të shtuar

Një nga shqetësimet më të mëdha në trajtimin e dhunës ndaj gruas, e në veçanti të dhunës në familje është trajtimi i rasteve me persona me të kaluar kriminale dhe veprat kur kryesi ka kërcënuar, përdorur apo posedon armë, e gjithë kjo për shkak të rrezikshmërisë së shtuar. Sistemi prokurorial do të avancojë punën e mekanizmave për vlerësimin e rrezikut përmes bashkëpunimit me Policinë e Kosovës. Për ta zvogëluar rrezikun për viktimat, sistemi prokurorial do t'i rishikojë dhe ndryshojë praktikën dhe politikën institucionale dhe kurdo që është e nevojshme do të ndërmarrë nisma në nivel shtetëror për t'i trajtuar boshllëqet ligjore.

Strategjia 2: Rritja e bashkëpunimit brenda dhe jashtë institucionit

Bashkëpunimi i ngushtë mes prokurorëve, mbrojtësve të viktimave dhe akterëve të tjerë është thelbësor për të siguruar një trajtim të drejtë dhe efektiv të këtyre rasteve. Veprat e përfshira në këtë objektiv ndodhin zakonisht në një kontekst shumë të ndjeshëm, ku çdo veprim i vonuar ose i pasaktë mund të ketë pasoja serioze për viktimat. Gjatë kohëzgjatjes së këtij plani do të angazhohemi për avancimin e bashkëpunimit në mes të prokurorëve dhe mbrojtësve të viktimave, duke siguruar një proces të ndjeshëm ndaj nevojave të tyre dhe, gjithashtu, duke ndihmuar në mbledhjen dhe ruajtjen e provave në mënyrë që të mundësohet një ndjekje e suksesshme penale.

Strategjia 3: Avancimi i qasjes së viktimave, mbrojtjes së viktimave dhe parandalimit të riviktimizimit

Sistemi prokurorial ka shtuar dukshëm angazhimin për mbrojtjen e viktimave përmes fuqizimit të mekanizmave ekzistues, qasjes më të lehtë në informacion për viktimat, por edhe vetëdijesimit të vazhdueshëm. Megjithatë, si sistem synojmë të bëjmë edhe më shumë - të identifikojmë mangësitë e sistemit, të unifikojmë më tutje praktikën dhe të sigurohemi për një qasje më proviktimë në punën tonë. Sistemi do të angazhohet edhe për ruajtjen e privatësisë së viktimave për të shmangur stigmën e mëtutjeshme dhe targetimin publik. Gjatë gjithë angazhimit tonë do të sigurojmë edhe një qasje më të afërt me komunitetet më të prekura nga disa dukuri dhe barrierat kulturore për të siguruar që këto komunitete të ndjehen të dëgjua, por që edhe njëkohësisht të punojmë për ndërgjegjësimin e tyre për t'u shmangur nga praktikën dhe narrativat e gabuara.

Objektivi 3. Shtimi i angazhimit për trajtimin e krimeve të luftës

Strategjia 1: Të sigurohet që hetimet dhe ndjekja penale të jenë në përputhje me standardet ndërkombëtare

Krimet e luftës paraqesin veprat që janë ndër më sfidueset për sistemin e drejtësisë, e në veçanti për sistemin prokurorial, duke pasur parasysh ndjeshmërinë e tyre, kërkesën e vazhdueshme të viktimave për drejtësi, provat e vjetruara dhe të munguara dhe mungesën në shumë raste edhe të kryesve. Megjithatë, përkundër të gjitha sfidave dhe stagnimit tash e shumë kohë të trajtimit të këtyre veprave, falë edhe fuqizimit të resurseve, kemi avancuar në ndjekjen penale të tyre. Prokurorët që merren me krimet e luftës duhet të kenë një nivel të lartë të njohurive dhe aftësive në fushën e drejtësisë ndërkombëtare dhe të drejtësisë penale, përfshirë njohuritë për ligjin humanitar ndërkombëtar dhe procedurat speciale për krimet e luftës, andaj edhe sistemi prokurorial në vazhdimësi do të angazhohet për ngritjen e kapaciteteve të prokurorëve dhe stafit profesional për të hetuar dhe ndjekur penalisht këto krime. Me qëllim të zvogëlimit të ngarkesës me lëndë do të miratohen edhe strategji të veçanta operative për të adresuar specifikat rreth këtyre veprave. Njëkohësisht do të punohet shumë për ruajtjen dhe avancimin e

bashkëpunimit rajonal për shkak edhe të ngjashmërisë së praktikave në disa nga vendet e rajonit.

Objektivi 4. Luftimi i terrorizmit, ekstremizmit dhe veprave kundër rendit kushtetues

Përderisa krimet e luftës janë të një rëndësie të veçantë për Republikën e Kosovës dhe qytetarët e saj, veprat siç janë terrorizmi, ekstremizmi dhe veprat e tjera kundër rendit kushtetues janë të një rëndësie tejkufitare për shkak të rrezikimit të sigurisë jo vetëm vendore, por edhe destabilizimit rajonal dhe global. Andaj, edhe në sistemin prokurorial, duke kuptuar barrën e peshës për trajtimin e këtyre rasteve do të angazhohemi fuqishëm në trajtimin efikas të tyre. Kjo do të bëhet përmes bashkëpunimit shumë të ngushtë me mekanizmat e tjerë vendorë dhe ndërkombëtarë për një hetim të përpiktë dhe ndjekjen penale duke i mbajtur përgjegjës autorët dhe duke ndërprerë rrjetet e organizuara.

Strategjia 1: Forcimi i bashkëpunimit ndërinstitucional dhe ndërkombëtar

Luftimi i veprave të kësaj natyre domosdoshmërisht kërkon një qasje ekipore me Policinë e Kosovës dhe përdorimin e të dhënave nga inteligjenca, me qëllim të luftimit me sukses të këtyre fenomeneve. Sistemi prokurorial do të bashkëpunojë ngushtë me agjenci të specializuara ndërkombëtare, me qëllim të sigurimit të provave të qëndrueshme dhe të pranueshme në gjykatë dhe identifikimin e kryesve dhe veprimeve të tyre jashtë vendit, por të cilat njëkohësisht përbëjnë rrezik edhe për sigurinë e vendit, rajonit dhe sigurinë ndërkombëtare. Sistemi do të angazhohet për përmbushjen edhe të obligimeve të marra me Planin shtetëror kundër terrorizmit.

Strategji 2: Angazhimi për hetime në përputhje me standardet ndërkombëtare

Sistemi prokurorial do të angazhohet për hetimin e atyre që komplotojnë ose veprojnë për të kërcënuar sigurinë nacionale dhe ndërkombëtare, detektimin dhe ndërprerjen e mbështetjes financiare për rrjetet që mbështesin këto aktivitete dhe angazhim të fuqishëm për mbledhjen e provave dhe përfaqësim efektiv në gjykatë për të siguruar dënime meritore.

Strategjia 3. Rritja e efikasitetit për luftimin e korrupsionit, krimeve ekonomike, shpërlarjes së parave, krimit të organizuar dhe rasteve të shënjestruara

Prioritizimi i veprave penale është një ndër segmentet kyçe në punën e Prokurorit të Shtetit, i cili ka sjellë rritjen e efikasitetit në shkallë të madhe të veprave specifike me theks të veçantë veprave kundër korrupsionit, krimeve ekonomike, shpërlarjes së parave dhe krimit të organizuar. Efikasitetit në këtë luftë ka qenë një sfidë e madhe, por gjithashtu një përvojë që ka kërkuar rritje të vazhdueshme të kapaciteteve për luftimin e këtyre veprave. Rritja e efikasitetit është e lidhur ngushtë me zhvillimet e strategjive të reja, përdorimin e teknologjisë dhe forcimin e bashkëpunimit ndërkombëtar.

Objektivi 5. Sigurimi i një sistemi efikas të ndjekjes penale

Një sistem efikas iu mundëson qytetarëve të gëzojnë të drejtat e tyre themelore. Për të rritur efikasitetin në hetimin e të gjitha veprave penale është thelbësor të sigurohet koordinimi i ngushtë ndërmjet prokurorisë, policisë dhe institucioneve të tjera relevante dhe të sigurohet shkëmbimi i shpejtë dhe i saktë i informacionit. Trajnimi i vazhdueshëm i prokurorëve dhe hetuesve për përdorimin e metodave bashkëkohore hetimore dhe teknologjive të reja është po aq i rëndësishëm. Po ashtu duhet të zhvillohen protokolle të qarta për menaxhimin e provave, mbledhjen e të dhënave dhe respektimin e të drejtave të palëve të përfshira në procesin hetimor. Për ngritje të efikasitetit është thelbësore të ketë mbikëqyrje të vazhdueshme për të vlerësuar efikasitetin e angazhimit, identifikimin e dobësive dhe nevojat për përmirësim dhe gjetjen e mënyrave inovative për avancimin e proceseve.

Strategjia 1: Zvogëlimi i numrit të lëndëve të pazgjidhura penale

Kjo strategji ndërthen në vete një numër hapash dhe atë duke filluar nga: kategorizimi i lëndëve sipas urgjencës dhe rëndësisë, identifikimin e çështjeve që ka mundësi të zgjidhen përmes procedurës alternative të rasteve, digjitalizimit dhe shfytëzimit të teknologjisë për të ndjekur progresin e çështjeve, koordinimit me gjykatat për të reduktuar vonesat procedurale dhe për të siguruar të mos ketë dështim të seancave për shkak të mungesës së prokurorëve. Sistemi prokurorial do të angazhohet edhe për fuqizimin e mekanizmave të mbikëqyrjes përmes sistemit SMIL, vendosjen e treguesve të qartë të performancës për prokurorët dhe personelin mbështetës për të ndjekur progresin dhe për të mbajtur përgjegjësinë. Një tjetër fokus do të jetë zgjidhja e çështjes së ngarkesës me lëndët PPP, duke gjetur mënyra inovative për adresim të këtyre problematikave.

Strategjia 2: Zgjidhjen e lëndëve përmes procedurave alternative

Sistemi prokurorial do të punojë për zhvillim të strategjive, të cilat ndihmojnë në përdorimin më efektiv të zgjidhjeve alternative të rasteve, duke synuar zvogëlimin e ngarkesës me lëndë të sistemit prokurorial dhe duke ofruar njëkohësisht edhe një zgjidhje më të shpejtë dhe efektive drejt drejtësisë. Në këtë kontekst, sistemi prokurorial synon edhe zbatimin e teknologjisë informative për identifikim të hershëm të rasteve të përshtatshme për zgjidhje alternative (si veprat më të lehta, rastet tek kryesit pa ndonjë të kaluar kriminale etj), bazuar në kritere të përcaktuara paraprakisht, duke u angazhuar për një transparencë dhe informacion për palët e përfshira.

Shtylla III: Transparenca dhe qasja në drejtësi

Rritja e transparencës së sistemit prokurorial është domosdoshmëri e kohës, me qëllim që të krijohet një lidhje më e fortë me publikun dhe ndërtim të besimit të qëndrueshëm në drejtësinë që ne ofrojmë. Publikimi proaktiv, përgjigja në kërkesën për qasje në dokumente të sistemit dhe ngritja e bashkëpunimit me organizatat që monitorojnë punën e sistemit prokurorial janë jetike për forcimin e integritetit institucional, duke synuar një mjedis ku transparenca nuk shihet si detyrim, por si një mundësi.

Objektivi 1. Transparenca përmes publikimit proaktiv dhe qasjes në dokumente

Ky objektivi synon të rrisë transparencën dhe të mbështesë të drejtën e qytetarëve për qasje në informacion, duke balancuar nevojën për konfidencialitet të çështjeve në kuadër të ndjekjes penale, ruajtje të privatësisë dhe të të dhënave të ndjeshme të viktimave dhe dëshmitarëve. Sistemi prokurorial do të avancojë mekanizmat dhe praktikatat e veta përmes publikimit të rregullt dhe të përditësuar të të dhënave të performancës së prokurorisë dhe prokurorëve, rasteve disiplinore, dokumenteve të Këshillit dhe Prokurorit të Shtetit, si dhe dokumenteve dhe statistikave të tjera institucionale.

Strategjia 1: Fuqizimi i mekanizmave përgjegjës për përditësimin e uebportalit me dokumentet e nevojshme

Sistemi prokurorial do të zhvillojë një sistem të përshtatshëm për qytetarët dhe palët e interesuara për të kërkuar qasje në dokumentet publike. Praktika e zbulimit të kërkesave do të rishikohet me qëllim që të sigurohet një përgjigje e shpejtë ndaj kërkesave dhe të zbulohen sa më shumë informacione që është e mundur, duke siguruar zbatim të duhur të ligjeve dhe të rregulloreve.

Strategjia 2: Përmirësimi i qasjes në dokumentet dhe informacionet e sistemit prokurorial

Sistemi prokurorial do të rishikojë praktikën e zbulimit proaktiv të informacionit në portalin e internetit me qëllim që të sigurojë publikim me kohë të informacionit me interes të përgjithshëm për publikun dhe të zbulojë sa më shumë informacione që të jetë e mundur, duke siguruar zbatim të duhur të ligjeve dhe rregulloreve.

Objektivi 2. Avancimi i bashkëpunimit me shoqërinë civile, mediat

dhe partnerët ndërkombëtarë

Strategjia 1: *Angazhimi i shtuar me organizatat e shoqërisë civile dhe mediat*

Sistemi prokurorial ka për synim avancimin e kësaj objektive duke rritur dhe përmirësuar angazhimin me organizatat e shoqërisë civile me fokus të veçantë ato të cilat drejtëpërdrejt monitorojnë punën e sistemit prokurorial dhe sistemit të drejtësisë në përgjithësi për të kuptuar edhe nga jashtë mangësitë e sistemit dhe se si më së miri mund t'i adresojmë ato. Lehtësimi i qasjes së shoqërisë civile për të monitoruar aktivitetet kryesore të prokurorisë, duke siguruar vlerësim të pavarur të veprimtarisë së Këshillit dhe Prokurorit të Shtetit. Sistemi prokurorial synon edhe rritjen e prezencës në media për të pasqyruar punën e sistemit prokurorial, vazhdimin e publikimit në livestream të takimeve të Këshillit, të organizojë konferenca për shtyp dhe të mbajë takime të rregullta me mediet dhe shoqërinë civile.

Strategjia 2: *Ngritja e bashkëpunimit dhe partneritetit me partnerët ndërkombëtarë*

Partnerët ndërkombëtarë ndër vite kanë kontribuar për ngritjen e profesionalizmit të sistemit duke ofruar këshilla dhe zhvillim të kapaciteteve. Sistemi prokurorial do të vazhdojë edhe më fuqishëm bashkëpunimin me partnerët ndërkombëtarë për të avancuar punën e sistemit dhe për të identifikuar e përmirësuar të metat e mundshme.

Buxheti

Këshilli menaxhon buxhetin vjetor për tërë sistemin prokurorial në mënyrë të pavarur dhe mban përgjegjësi për mbikëqyrjen e shpenzimeve, alokimin e fondeve, mirëmbajtjen e llogarive të sakta dhe aktuale, si dhe auditimin financiar. Këshilli ka katër programe buxhetore: Prokurorët dhe Administrata, në të cilin përfshihen të gjitha shpenzimet e krijuara nga Këshilli dhe Prokurori i Shtetit, Prokurorët Specialë, Zyra për Mbrojtje dhe Ndihmë Viktimave dhe Njësia Kundër Krimeve Ekonomike.

Këshilli Prokurorial, përmes kërkesës buxhetore për vitin 2025, ka kërkuar gjithsej 23,390,880.00€ dhe 273 pozita të reja (31 prokurorë dhe 242 pozita për staf administrativ). Sipas kategorive ekonomike, Këshilli ka kërkuar për:

1. Kategorinë e pagave dhe shtesave: 17,098,021€ për 1,237 punonjës të sistemit (për 964 pozita të ndara me buxhetin e vitit 2024 si dhe 273 pozita të reja, mjete për mbulimin e pagave dhe shtesave të përcaktuara me akte ligjore dhe nënligjore);
2. Kategorinë e mallrave dhe shërbimeve: 3,958,729.00€;
3. Kategorinë e shërbimeve komunale: 199,630.00€ dhe
4. Kategorinë e investimeve kapitale: 2,434,500.00€.

Bazuar në Ligjin Nr.08/L-332 mbi ndarjet buxhetore për buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2025, Këshillit i janë ndarë gjithsejtë 18,913,922€, të ndara në katër kategori ekonomike dhe atë në:

1. Kategorinë e pagave dhe shtesave : 12,829,792.00€ për 969 punonjës të sistemit (shtesë janë aprovuar vetëm 5 pozita, dhe atë mbrojtës të viktimave për programin Zyra për Mbrojtje dhe Ndihmë Viktimave),
2. Kategorinë e mallrave dhe shërbimeve: 3,450,000.00€,

3. Kategorinë e shërbimeve komunale: 199,630.00€ dhe
4. Kategorinë e investimeve kapitale: 2,434,500.00€.

Mosaprovimi i tërësishëm i kërkesës buxhetore, të miratuar nga Këshilli do të ndikojë negativisht në mbarëvajtjen e punës në sistemin prokurorial, sidomos në kategorinë e pagave dhe shtesave (të paaprovuara nga Qeveria kanë mbetur 268 pozita dhe 4,268,229 Euro) ku si sfida kryesore mbetet procedimi i pagave për stafin mbështetës sipas Rregullores për Klasifikim të Vendeve të Punës.

Monitorimi i zbatimit të Planit strategjik

Plani strategjik dhe Plani i veprimit janë dokumente strategjike institucionale, të cilat kërkojnë përkushtim dhe vullnet të sistemit prokurorial në zbatimin e politikave dhe arritjen e objektivave të parapara. Ndryshimet legjislative, institucionale, strukturore dhe në përgjithësi mjedisi i pasigurt mund të rezultojnë në paraqitjen e sfidave dhe problemeve në zbatim të strategjisë. Identifikimi në kohë i sfidave dhe problemeve ka rol kyç në suksesin e zbatimit të strategjisë. Për këtë arsye në mënyrë të vazhdueshme do të bëhet monitorimi i zbatimit dhe vlerësimi i strategjisë.

Në këtë drejtim, Këshilli do të themelojë një grup punues për monitorimin e zbatimit të Planit strategjik të sistemit prokurorial 2025- 2027, i cili do t'i raportojë Këshillit Prokuorial. Monitorimi do të bëhet në baza vjetore, me ç'rast do të hartohen raporte të aktiviteteve të paraqitura në Planin e veprimit, treguesit dhe afatet e tyre kohore. Përmes këtyre raporteve, përveç nivelit të zbatimit, do të identifikohen edhe sfidat e zbatimit dhe do të bëhen rekomandimet për tejkalimin e tyre. Këto raporte do të prezantohen në Këshill.

Ndërsa në fund të zbatimit të Strategjisë do të bëhet vlerësimi ex-post për të analizuar dhe vlerësuar nëse ajo ka arritur objektivat e synuara. Ky vlerësim do të shërbejë edhe gjatë hartimit të strategjisë së re.

Plani i veprimit

Për t'u siguruar që sistemi prokurorial do të përmbushë objektivat e përcaktuara dhe të vendosura në këtë Plan strategjik, treguesit kryesorë të performancës do të përdoren për të monitoruar aktivitetet e planifikuara (monitorimin e progresit) dhe për të vlerësuar arritjen e objektivave kryesore (monitorimin e rezultateve), ndërkohë që rreziqet do të identifikohen dhe menaxhohen paralelisht. Një raport vjetor i performancës do të mundësojë që përgjatë periudhës trevjeçare, nëse janë duke u realizuar mjaftueshëm qëllimet strategjike.

Strategjia 1: Angazhimi i shtuar me organizatat e shoqërisë civile dhe mediat

Sistemi prokurorial ka për synim avancimin e kësaj objektivë duke rritur dhe përmirësuar angazhimin me organizatat e shoqërisë civile me fokus të veçantë ato të cilat drejtëpërdrejt monitorojnë punën e sistemit prokurorial dhe sistemit të drejtësisë në përgjithësi për të kuptuar edhe nga jashtë mangësitë e sistemit dhe se si më së miri mund t'i adresojmë ato. Lehtësimi i qasjes së shoqërisë civile për të monitoruar aktivitetet kryesore të prokurorisë, duke siguruar vlerësim të pavarur të veprimitarisë së Këshillit dhe Prokurorit të Shtetit. Sistemi prokurorial synon edhe rritjen e prezencës në media për të pasqyruar punën e sistemit prokurorial, vazhdimin e publikimit në live-stream të takimeve të Këshillit, të organizojë konferenca për shtyp dhe të mbajë takime të rregullta me mediet dhe shoqërinë civile.

Strategjia 2: Ngjitja e bashkëpunimit dhe partneritetit me partnerët ndërkombëtarë

Partnerët ndërkombëtarë ndër vite kanë kontribuar për ngritjen e profesionalizmit të sistemit duke ofruar këshilla dhe zhvillim të kapaciteteve. Sistemi prokurorial do të vazhdojë edhe më fuqishëm bashkëpunimin me partnerët ndërkombëtarë për të avancuar punën e sistemit dhe për të identifikuar e përmirësuar të metat e mundshme.

Buxheti

Këshilli menaxhon buxhetin vjetor për tërë sistemin prokurorial në mënyrë të pavarur dhe mban përgjegjësi për mbikëqyrjen e shpenzimeve, alokimin e fondeve, mirëmbajtjen e llogarive të sakta dhe aktuale, si dhe auditimin financiar. Këshilli ka katër programe buxhetore: Prokurorët dhe Administrata, në të cilin përfshihen të gjitha shpenzimet e krijuara nga Këshilli dhe Prokurori i Shtetit, Prokurorët Specialë, Zyra për Mbrojtje dhe Ndihmë Viktimave dhe Njësia Kundër Krimeve Ekonomike.

Këshilli Prokurorial, përmasë kërkesës buxhetore për vitin 2025, ka kërkuar gjithsej 23,390,880.00€ dhe 273 pozita të reja (31 prokurorë dhe 242 pozita për staf administrativ). Sipas kategorive ekonomike, Këshilli ka kërkuar për:

1. Kategorinë e pagave dhe shtesave: 17,098,021€ për 1,237 punonjës të sistemit (për 964 pozita të ndara me buxhetin e vitit 2024 si dhe 273 pozita të reja, mjete për mbulimin e pagave dhe shtesave të përcaktuara me akte ligjore dhe nënligjore);
2. Kategorinë e mallrave dhe shërbimeve: 3,958,729.00€;
3. Kategorinë e shërbimeve komunale: 199,630.00€ dhe
4. Kategorinë e investimeve kapitale: 2,434,500.00€.

Bazuar në Ligjin Nr.08/L-332 mbi ndarjet buxhetore për buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2025, Këshilli i Janë ndarë gjithsejtë 18,913,922€, të ndara në katër kategori ekonomike dhe atë në:

1. Kategorinë e pagave dhe shtesave : 12,829,792.00€ për 969 punonjës të sistemit (shtesë janë aprovuar vetëm 5 pozita, dhe atë mbrojtës të viktimave për programin Zyra për Mbrojtje dhe Ndihmë Viktimave),
2. Kategorinë e mallrave dhe shërbimeve: 3,450,000.00€,
3. Kategorinë e shërbimeve komunale: 199,630.00€ dhe
4. Kategorinë e investimeve kapitale: 2,434,500.00€.

Mosaprovimi i tërësishëm i kërkesës buxhetore, të miratuar nga Këshilli do të ndikojë negativisht në mbarëvajtjen e punës në sistemin prokurorial, sidomos në kategorinë e pagave dhe shtesave (të paaprovuara nga Qeveria kanë mbetur 268 pozita dhe 4,268,229 Euro) ku si sfida kryesore mbetet procedimi i pagave për stafin mbështetës sipas Rregullores për Klasifikim të Vendeve të Punës.

Monitorimi i zbatimit të Planit strategjik

Plani strategjik dhe Plani i veprimit janë dokumente strategjike institucionale, të cilat kërkojnë përkushtim dhe vullnet të sistemit prokurorial në zbatimin e politikave dhe arritjen e objektivave të parapara. Ndryshimet legjislative, institucionale, strukturore dhe në përgjithësi mjedisi i pasigurt mund të rezultojnë në paraqitjen e sfidave dhe problemeve në zbatim të strategjisë. Identifikimi në kohë i sfidave dhe problemeve ka rol kyç në suksesin e zbatimit të strategjisë. Për këtë arsye në mënyrë të vazhdueshme do të bëhet monitorimi i zbatimit dhe vlerësimi i strategjisë.

Në këtë drejtim, Këshilli do të themelojë një grup punues për monitorimin e zbatimit të Planit strategjik të sistemit prokurorial 2025- 2027, i cili do t'i raportojë Këshillit Prokurorial. Monitorimi do të bëhet në baza vjetore, me ç'rast do të hartohen raporte të aktiviteteve të paraqitura në Planin e veprimit, treguesit dhe afatet e tyre kohore. Përmes këtyre raporteve, përveç nivelit të zbatimit, do të identifikohen edhe sfidat e zbatimit dhe do të bëhen rekomandimet për tejkalimin e tyre. Këto raporte do të prezantohen në Këshill.

Ndërsa në fund të zbatimit të Strategjisë do të bëhet vlerësimi ex-post për të analizuar dhe vlerësuar nëse ajo ka arritur objektivat e synuara. Ky vlerësim do të shërbejë edhe gjatë hartimit të strategjisë së re.

Plani i veprimit

Për t'u siguruar që sistemi prokurorial do të përmbushë objektivat e përcaktuara dhe të vendosura në këtë Plan strategjik, treguesit kryesorë të performancës do të përdoren për të monitoruar aktivitetet e planifikuara (monitorimin e progresit) dhe për të vlerësuar arritjen e objektivave kryesore (monitorimin e rezultateve), ndërkohë që reziqet do të identifikohen dhe menaxhohen paralelisht. Një raport vjetor i performancës do të mundësojë që përgjatë periudhës trevjeçare, nëse janë duke u realizuar mjafueshëm qëllimet strategjike.

Objektivi strategjik 1.1: Ruajtja e pavarësisë së sistemit prokurorial

Strategjia 1: Angazhimi për shmangien e ndikimit të padrejtë në punën e sistemit prokurorial

Nr.	AKTIVITETI	Njësia përgjegjëse	Njësia bashkëpunuese	Kufiri kohor	Treguesi
1.1.1	<p>Rishikimi ligjor për të identifikuar zbrastëirat në legjislacion në lidhje me ndikimin e panevojshëm dhe pavarësinë e prokurorisë.</p> <p>Krijimi/forcimi i Njesisë së Përkushtuar të Monitorimit të Pavarësisë së Prokurorisë për të gjurmuar dhe raportuar rastet e ndikimit të padrejtë.</p> <p>Avancimi i programeve për ngritjen e kapaciteteve për prokurorët dhe zyrtarët e tjerë për njohjen dhe rezistimin e ndikimit të padrejtë.</p>	<p>Komisioni për Çështje Normative</p> <p>KPK</p>	<p>KPK, PSH, Shoqata e Prokurorëve.</p> <p>KPK PSH</p>	<p>T 3- T 4 2025</p> <p>T3/2025</p> <p>T3+TM4/2025</p>	<p>Treguesi cilësor: Besimi i prokurorëve në identifikimin dhe rezistimin e ndikimit të panevojshëm, i matur përmes vlerësimeve pas trajnimit.</p> <p>Treguesit sasior: Ndryshimet legjislative të propozuara për të mbrojtur pavarësinë e prokurorisë.</p> <p>Numri i rasteve raportuara dhe të zgjidhura të sinjalizimit dhe përqindja e rasteve të sinjalizuesve, brenda një afati të caktuar.</p> <p>Numri i prokurorëve dhe zyrtarëve të tjerë të trajnuar për t'i rezistuar ndikimit të padrejtë dhe vendimmarrjes etike.</p>
1.1.2	<p>Forcimi i mekanizmave të mbrojtjes së sinjalizuesve, duke futur një sistem të pavarur</p>	<p>PSH KPK</p>	<p>SKPK</p>	<p>T3/2025</p>	<p>Treguesi cilësor: Niveli i besimit midis prokurorëve dhe stafit të administratës në përdorimin e platformës së</p>

	<p>raportimi për rastet e ndikimit të padrejtë.</p> <p>Avancim i akteve normative për mbrojtjen e sinjalizuesve, duke garantuar anonimitetin dhe sigurinë për prokurorët raportues.</p> <p>Kryerja e auditimeve periodike të raporteve të sinjalizuesve për të vlerësuar efektivitetin dhe shkallën e përgjigjes.</p>	KQN	KPK	T3+TM4/2025	<p>sinjalizuesve, i matur nëpërmjet anketave anonime mbi sigurinë dhe efektivitetin e perceptuar.</p> <p>Treguesi sasior: Numri i raporteve të sinjalizuesve të dorëzuar çdo vit dhe përqindja e raporteve që rezultojnë në hetime ose veprime korrigjuese.</p> <p>Raportet e auditimit të paraqitura në Këshill dhe të trajtuara nga KPK-ja.</p>
1.1.3	<p>Krijimi i Komisionit mbikëqyrës për të monitoruar dhe trajtuar ndikimin e padrejtë brenda sistemit prokurorial.</p>	KPK PSH	Shoqata e Prokurorëve	T3/2025 dhe në vazhdim	<p>Treguesi cilësor: Efektiviteti i organit mbikëqyrës në adresimin e ndikimit të padrejtë, i vlerësuar përmes raporteve vjetore dhe komenteve të palëve të interesuara.</p> <p>Treguesi sasior: Numri i rasteve të shqyrtuara nga organi mbikëqyrës dhe përqindja e rasteve që kanë rezultuar në masa korrigjuese.</p>
1.1.4	Zhvillimi dhe zbatimi i masave të situara të sigurisë për prokurorët që	KPK	PSH, Policia e Kosovës,	2025-2027 Gjatë gjithë viteve	Treguesi cilësor: Perceptimi i prokurorëve për sigurinë dhe mbrojtjen në punën e tyre, i

	përballen me kërcënime ose presione të panevojshme.			Shoqata e Prokurorëve.		matur nëpërmjet anketave periodike. Treguesi sasior: Numri i masave mbrojtëse të zbatuara (p.sh. personeli i sigurisë i caktuar, krijohen kanale të sigurta komunikimi) dhe përqindja e prokurorëve që marrin mbështetje mbrojtëse kur është e nevojshme.
